

VAKSINIME PËR TË GJITHË

- + Vaksinat kundër gripit
- + Vaksinat Pfizer dhe J&J kundër COVID-19
 - Dozat për të rriturit
 - Dozat për fëmijë nga 5 vjeç e lart
 - Dozat shtesë të serisë primare për personat me imunitet të cenuar
 - Injeksionet përforcuese

Ofrohen këtu për të gjithë ata që kualifikohen

Me COVID-19 dhe sezonin e gripit që shfaqen së bashku është më e rëndësishme se kurrë të mbron veten dhe ata pranë jush nga sëmurja.

Vaksinat kundër COVID-19 dhe gripit janë të sigurt dhe tejet efikase në reduktimin e rrezikut nga sëmurja, shtrimi në spital dhe deri dhe vdekja.

Vaksinat kundër COVID-19 dhe gripit mund t'i bëni njëherësh pa shpenzime nga ana juaj.

Mësoni më tepër se cila vaksinë është e duhura për ju. Skanoni kodin QR ose telefononi në nr. **1-844-NYC-4NYC** (1-844-692-4692).

Mësoni më shumë
për vaksinat
kundër COVID-19



Mësoni më shumë
për vaksinën
kundër gripit



Kush duhet të vaksinohet kundër gripit dhe COVID-19?

Vaksina kundër gripit

Të gjithë njerëzit nga gjashtë muajsh e lart duhet ta bëjnë çdo vit vaksinën kundër gripit, sidomos:

- + Fëmijët nën 2 vjeç
- + Njerëzit mbi 65 vjeç
- + Gratë shtatzëna apo që kanë kryer lindje së fundi
- + Njerëzit me probleme mjekësore si p.sh. diabeti, astma, sëmundja e zemrës apo HIV
- + Punonjësit e shërbimeve bazike, duke përfshirë punonjësit shëndetësorë dhe kujdestarët e njerëzve që janë në rrezik më të lartë sëmurjeje. Ata që kujdesen për fëmijët, sidomos për foshnja nën gjashtë muaj, duhet ta kryejnë gjithashtu vaksinën kundër gripit.

Vaksina kundër COVID-19

Shumica e njujorkezëve gëzojnë tani të drejtën e kryerjes së një vaksine kundër COVID-19:

- + Personat e moshës 5 deri 11 vjeç mund të bëjnë dy doza pediatrike (një e treta e fuqisë) së Pfizer-BioNTech
- + Njerëzit nga 12 vjeç e lart mund të bëjnë dy doza të vaksinës Pfizer-BioNTech
- + Njerëzit 18 vjeç e lart mund të kryejnë dy doza të vaksinës Moderna ose një dozë të Johnson & Johnson/Janssen

Dozat shtesë të serisë primare të vaksinës së Pfizer ose të Moderna kundër COVID-19

Dozat shtesë të serisë primare u ofrohen personave që kanë kryer dozën e dytë të vaksinës kundër COVID-19 të paktën 28 ditë më parë dhe kanë sistem të dobësuar imunitar për shkak të ndonjë problemi apo trajtimi.

Këto përfshijnë:

- + Trajtim aktiv kundër kancerit
- + Transplantim organi dhe mjekime për të reduktuar fuqinë e sistemit imunitar
- + Transplantim qelizash staminale brenda 2 viteve të fundit
- + Imunodeficiencë primare e rëndë ose mesatare
- + HIV i avancuar ose i patrajtuar
- + Trajtim aktiv me një dozë të lartë kortikosteroidësh ose barnash të tjera që e dobësojnë sistemin imunitar në shkallë të lehtë apo të mesme

Duhet të jeni 5 vjeç e lart për të kryer dozën shtesë të serisë primare të Pfizer dhe 18 vjeç e lart për të kryer dozën shtesë të serisë primare të Moderna. Dozat shtesë të serisë primare nuk rekomandohen për shumicën e njerëzve me probleme të tjera mjekësore, si p.sh. diabet, sëmundje të zemrës apo të mushkërive.

Doza përforcuese kundër COVID-19 - Marrësit e vaksinave Pfizer dhe Moderna

Gjithkush nga 12 vjeç e lart duhet të bëjë një injeksion përforcues të paktën 5 muaj pas bërjes së dozës së dytë të serisë primare të Pfizer ose Moderna të vaksinimit kundër COVID-19.

Njerëzit që kanë kryer dy injeksione të vaksinës Pfizer ose Moderna duhet të kryejnë të njëjtën vaksinë si përforcuesja, por kanë mundësinë e kryerjes së cilësdo prej tri llojeve të vaksinave të autorizuara në SHBA.

Personat 12-17 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi pesë muaj më parë përfitojnë vetëm injeksionin përforcues të Pfizer. Fëmijë të caktuar me imunitet të cenuar të moshës 5-11 vjeç mund të kualifikohen për një dozë shtesë të vaksinës së Pfizer 28 ditë pas injeksionit të dytë.

Doza përforcuese kundër COVID-19 - Marrësit e vaksinave Johnson & Johnson

Gjithkush nga 18 vjeç e lart duhet të bëjë një injeksion përforcues të paktën dy muaj pas bërjes së vaksinës së parë njëdozëshe kundër COVID-19. Injeksionet përforcuese të Pfizer ose Moderna (vaksinat mRNA COVID-19) preferohen në shumicën e rasteve.

Spitalet në sistemin e NYC Health + Hospitals ofrojnë vaksinat Pfizer dhe J&J. Qendrat e NYC Health + Hospitals/Gotham Health ofrojnë vaksinën Moderna. Për një listë të plotë të pikave, vizitoni faqen tonë në internet: nychealthandhospitals.org.